



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PERMBARUESE GJYQESORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Adresa: Rr. "Aleksandi i Madh", Pall "Mesaplik", Kati 2, Tiranë Cel.0682000133, email:kuciensola@gmail.com.

Nr.48/Prot.

Tiranë, me dt.21/01/2019

**Lënda:** Urdhër për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitore

**Drejtuar :** Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

DELVINË

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. certifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.165/Regj, bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.191 Vendimi, datë; 19.11.2002, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë,

KONSTATOVA:

Se me datë; 13.11.2017 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", Vendimi "Për transferimin e çështjes përmbarimore" nga ana e Shërbimit Përmbarimor "Star" sh.p.k, sot Shërbimi Përmbarimor "FS" sh.p.k, së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Akt Marrëveshje e Huasë, datë 11.07.1996, me palë dhe objekt:

Kreditor : Agjencia e Trajtimit të Kredive

Debitor : Zeman Hysi

Objekti : Kthim Shume

Shërbimi përmbarimor për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv si dhe në mbështetje të nenit 133 të K. Pr. Civile ka bërë shpalljen e njoftimit për vazhdimin e ekzekutimit të titullit. Në asnjë rast pala debitore nuk ka vepruar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv në përputhje me afatin e parashikuar në nenin 133 të K. Pr. Civile. Për këtë arsye, bazuar në nenin 519 të K.Pr. Civile, ekzekutimi i titullit Ka kaluar në ekzekutim të detyrueshem dhe për rrjedhoj, refreuar nenit 527, 529 e në vijim të K. Pr. Civile është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros mbi llogarinë e palës debitore.

Pala kreditore me shkresën nr. 9317/1 prot, datë 18.01.2019, depozituar pranë nesh menr. 1920/1 prot, datë 21.01.2019, informon se pala debitore Zeman Hysi ka lënë kolateral për marrjen e kredisë pasurinë e llojit "Oficinë", të ndodhur në Delvinë, sipas vërtetimit hipotekor, me nr. 737 e inskriptuar më datë 29.06.1995.

Në këto kushte, për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, duhet që nga ana ime me cilësinë e përmbaruese gjyqësore të urdhëroj vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitore.

Sa sipër, bazuar në neni 560 e në vijim të K.Pr.Civile

URDHËROJ:

Vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitore **Zeman Myftar Hysi, i datëlindjes 01.04.1957, në shumën e detyrimit prej 4,564,573 (katër milion e**

**pesëqindë e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqindë e shtatëdhjetë e tre) Lekë si dhe tarifën e shërbimit përmbartimor në masën prej 435,855 lekë me tvsh.**

Pasuria mbi të cilën duhet të vendoset masa e sekuestros përbëhet nga:

- "Oficinë", e ndodhur në Delvinë, sipas vërtetimit hipotekor, me nr. 737 e inskriptuar më datë 29.06.1995.

Sekuestro të vendoset në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.191 Vendimi, datë; 19.11.2002, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke patur parasysh radhën e preferimit, sipas nenit 605 K.Civil.

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Shënim: *Bashkalidhur Urdhër Ekzekutimi Nr.191 Vendimi, datë; 19.11.2002, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë*

**PËRMBARUESE GJYQËSORE**

**Ensola KUÇI**

